REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TË TIRANËS
Nr 2061 i Aktit

2061

# V E N D I M
## MBI
## RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot më 23.2.1994 në gjykatën e rrethit të Tiranës, unë gjygjëtarja Florina Tepu, mbasi u njoha me materialin e paraqitur prej Gëzim Tomanit banues në Tiranë, për t'u rregjistruar si person juridik:

## K O N S T A T O V A

Se Gëzim Tomani ka paraqitur kërkesën për t'u rregjistruar si person juridik shqipëtar të organizuar në shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K.të emërtuar "TOMANI" për të ushtruar aktivitet privat si më poshtë:

Tregëtimin me shumicë e pakicë, import eksport të artikujve të ndryshëm si ushqim social, konfeksione, paisje dhe enë guzhine, ushqimore prodhime bujqësore e blektorale, bimë mjeksore, artikuj industrial, makineri e paisje, pjesë ndërimi, lëndë të para, karburant e lubrifikant, duke bërë dhe ambalazhimin dhe paketimin e tyre.

Përpunimin dhe prodhimin e artikujve të brumit dhe të pastiçerisë, si dhe aktivitete të tjera që do të shifen me interesë nga shoqeria.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit Nr 7512 datë 10.8.1991, të ligjit Nr 7638 datë 19.11.1992 dhe të ligjit Nr 7667 datë 28.1.1993,

## V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik shqipëtar të shoqerisë tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K.të emërtuar "TOMANI" të përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administrator Gëzim Tomani me seli në Tiranë rruga Bajram Curri pall.490/9 shk.2 ap.8, për të ushtruar aktivitetin privat si më poshtë:

Tregëtimin me shumicë dhe pakicë, import eksport të artikujve të ndryshëm si ushqim social, konfeksione, paisje dhe enë guzhine, ushqimore, prodhime bujqësore e blektorale, bimë mjeksore, artikuj industrial makineri e paisje, pjesë ndërimi; lëndë të para, karburant e lubrifikant duke bërë dhe ambalazhimin dhe paketimin e tyre.

Përpunimi dhe prodhimi i artikujve të brumit dhe të pastiçeri si dhe aktivitete të tjera që do të shifen me interesë nga shoqeria.

Kapitali themeltar i shoqerisë është 100.000 lekë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankesë brënda 10 ditëve ng data e marrjes së vendimit.

G J Y G J Ë T A R J A
/Florina Tepu/

# A K T   T H E M E L I M I
## I
## SHOQERISË TREGËTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SH.P.K.
## TË EMËRTUAR "TOMANI"

Unë ortaku i vetëm Gëzim Tomani, i biri i Nazifit dhe i Dritës lindur në Tiranë më 27.4.1964 banues po në Tiranë rruga Bajram Curri pallati 490/9 shk.2 ap.8,vendosa të themeloi shoqerinë tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K.të emërtuar " TOMANI ".

Neni 1

Shoqeria do të ketë selin e saj në Tiranë rruga Bajram Gurri pall.490/9 shk.2 ap.8.,dhe veprimtaria e saj do të shtrihet për një periudhë kohe 10 vjeçare.

Emërtimi i shoqerisë është " TOMANI " SH.P.K.

Neni 2

Shoqeria është person juridik shqipëtar dhe do të ushtroj veprimtarin e saj në bazë të ligjit Nr 7512 datë 10.8.1991,të ligjit Nr 7638 datë 19.11.1992 dhe të ligjit 7667 datë 28.1.1993,të kodit civil e të akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 3

Shoqeria përgjigjet për detyrimet e veta me pasurin e saj. Ajo nuk,përgjigjet për detyrimet që ka administratori apo punonjës të tjerë nga aktiviteti i tyre jashtë kësaj shoqërie.

Neni 4

Kapitali themeltar fillestar i shoqerisë është 100.000 lekë të cilat u derdhën në llogarin bankare të shoqerisë dhe do të përdor për ushtrimin e aktivitetit të saj.

I gjithë kapitali është vënë nga ortaku i vetëm Gëzim Tomani i cili nënëshkruhet dhe shlyhet plotësisht prej tij.

Neni 5

Fitimi i shoqerisë pasi të jetë zbritur pjesa për krijimin e fondit rezerve ,do të përdoret sipas vendimit që do të marri ortaku.

Neni 6

Shoqeria është e detyruar të shlyej në vazhdimësi të gjitha detyrimet që krijohen gjatë aktivitetit të saj.

Neni 7

Në statutin që i bashkangjitet këtij akt themelimi,janë përcaktuar kërkesat ligjore kryesore të themelimit të një shoqerie tregëtare private shqipëtare.

Neni 8

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoq

me të punësuarit,administratorët të tretët etj,kur ato nuk mund të zgjidhen me mirkuptim,çështja do të mbetet në kopetencë të gjykatës që e shqyrton atë.

Neni 9

Objekti i veprimtarisë së shoqerisë do të jetë:

Tregëtim me shumicë dhe pakicë,import eksport të artikujve të ndryshëm si ushqim social,konfeksione,paisje dhe enë guzhine, ushqimore,prodhime bujqësore dhe blektorale,bimë mjeksore,artikuj industrial,makineri e paisje,pjesë ndërimi,lëndë të para,karburant e lubrifikante duke bërë dhe ambalazhimin dhe paketimin e tyre.

Përpunimi dhe prodhimi i artikujve brumit dhe të pastiçerisë si dhe aktivitete të tjera që do të shifen me interesë nga shoqeria.

THEMELUESI
ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR
/ GËZIM TOMANI /

Tiranë 21.2.1994

# S T A T U T

## I

## SHOQERISË TREGËTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TË EMËRTUAR " TOMANI " SH.P.K.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqerisë tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar " TOMANI " SH.P.K.,si dhe zhvillimi i veprimtarisë së saj.

Shoqeria themelohet nga ortaku i vetëm Gëzim Nazif Tomani , shqipëtar me banim në Tiranë rruga Bajram Curri pall.490/9 shk.2 ap.8.

## KREU I

## FORMA,EMËRTIMI,OBJEKTI,SELIA DHE KOHË ZGJATJA

### Neni 1

Shoqeria formohet në mbështetje të legjislacionit shqipëtar dhe është e formës të shoqerive tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar.

### Neni 2

Shoqeria është e emërtuar " TOMANI " SH.P.K.

### Neni 3

Objekti i veprimtarisë të shoqerisë do të jetë tregëtimi me shumicë dhe pakicë ,import eksport të artikujve të ndryshëm si ushqim social ,konfeksione,paisje dhe enë guzhine,ushqimore,prodhime bujqësore dhe blektorale,bimë mjeksore,artikuj industrial,makineri e paisje,pjesë ndërimi,lëndë të para,karburante e lubrifikante,duke bërë dhe paketimin dhe ambalazhimin e tyre.

Përpunimi dhe prodhimi i artikujve të brumit e të pastiçerisë, si dhe aktivitete të tjera që do të shifen me interes nga shoqeria.

### Neni 4

Selia e shoqerisë do të jetë në Tiranë rruga Bajram Curri pall.490/9 shk.2 ap.8.

Aktiviteti i shoqerisë do të kryhet në të gjithë teritorin e Republikës dhe mund të çeli zyra përfaqësimi,axhensi apo filjale edhe në rrethe të tjera të vendit.

Ndryshimi i selisë behet me miratim të ortakut të vetëm.

### Neni 5

Ko hë zgjatja e shoqerisë është përcaktuar për një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga data e rregjistrimit.Ky afat mund të ndryshohet me miratim të ortakut të vetëm.

## KREU II

## KAPITALI THEMELTAR,KONTRIBUTET DHE PJESËT E KAPITALIT

Neni 6

Kapitali themeltar fillestar i shoqerisë është 100.000 lekë.

Shoqeria mund të rris kapitalin themeltar fillestar gjatë aktivitetit të saj ,por nuk mund t'a uli atë nën kufirin e 100.000 lekëv

Neni 7

I gjithë kapitali themeltar është vënë nga ortaku i vetëm Gëzim Tomàni dhe është ndar në 100 pjesë me vlerë të çdo pjese 1000 lekë sejcila,të cilat nënshkruhen dhe shlyen plotësisht nga ortaku i vetëm. Shtimi i kapitalit mund të bëhet nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja.

Neni 8

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimnie,në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

Pjesët e kapitalit me vendim të ortakut të vetëm mund t'ju transferohen të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqeri duke i pranuar ata si ortak të rinj.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE,ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISË

Neni 9

Të gjitha vendimet merren nga ortaku i vetëm,i cili zëvendëson asamblen.Ortaku mund të autorizoi bashkshorten ose një person tjetër i zgjedhur prej tij për t'a përfaqësuar.

Neni 10

Marrja e vendimeve bëhet kur e gjykon vetë ortaku ,por mund të kërkohen dhe nga administratori apo eksperti kontabël.Vendimet merren për çështje të,tilla si :Emërimi apo shkarkimi i administratorit ,ekspertit kontabël,miratimin e raporteve të miradministrimit dhe të kontrollit miratimin e llogarisë vjetore dhe përdorimin e fitimit,ndryshime në statut për ndryshim kapitali, të kohës së veprimtarisë të shoqerisë,për likujdimin e shoqerisë,për shndërimin e shoqerisë në shoqeri të formave të tjera,për transferim të kapitalit themeltar tek të tretët etj.

Neni 11

Shoqeria mban dokumentacion të plotë për veprimet ekonomiko-financiare,i pasqyron ato në mënyrë kronologjike në librat kontable e në bilancet kontable.

Neni 12

Ortaku i vetëm i shoqerisë përballon humbjet e shoqerisë me kapitalin e vetë deri në kufirin e kapitalit themeltar.

Neni 13

Shoqeria administrohet nga një ose disa administrator,që janë persona fizik e që mund të jenë ose jo ortak në shoqeri.

- " -

Emërimi i administratorit mund të jetë me një mandat prej tre vitesh financiare e me të drejtë ri emërimi.

Administratorët janë përgjegjës ndaj shoqerisë ose ndaj të tretëve për shkeljet ligjore,për shkelje të statutit ose për faje të tjera të kryera gjatë administrimit.

Ortaku i vetëm ka kopetenca për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interesë të shoqerisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqerisë,me përjashtim të atyre kopetencave që ligja,statuti etj nuk ja u jep ortakëve.

Neni 14

Kontrolli financiar i shoqerisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar nga organi kopetent dhe i emëruar nga ortaku i vetëm me një afat prej tre vite financiare e me mundësi riemërimi.

KREU IV

VITI FINANÇIAR,LLOGARIT VJETORE DHE REZERVA E DOMOZDOSHME

Neni 15

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor përjashtuar vitin e parë që datë fillimi konsiderohet ajo e rregjistrimit.

Neni 16

Llogarit vjetore,inventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raporte të veçanta të hartura nga administratorët e eksperti kontabël miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brënda një afati tre mujor mbas datës së mbylljes së vitit financiar.

Neni 17

Mbas miratimit të llogarisë vjetore dhe evidentimit të ekzistencës të fitimit,ortaku gjykon dhe vendos për krijimin nga fitimi të fondit rezervë si dhe për përdorimin e pjesës tjetër të fitimit.

KREU V

DISPOZITA TË TJERA

Neni 18

Shoqeria mund të prishet para afatit të caktuar në këtë statut, në rastet kur ndryshon afati ose kur ka një prishje të parakohëshme për shkaqe të ndryshme.

Neni 19

Shoqeria hynë në proçesin e likujdimit që në momentin e prishjes të saj .Për kryerjen e këtij proçesi duhet të emërohet një ose disa lijkujdator,të cilët ndjekin operacionet e likujdimit deri në përfundim dhe i paraqesin ortakut raportin mbi gjëndjen e aktivit e të pasivit dhe bilancin financiar përfundimtar të shoqerisë.

- " -

në përfundim të veprimeve të likujdimit,ortaku vendos për heqen e mandatit të likujduesit dhe për përfundimin e proçesit të likujdimit.

Të gjitha detyrimet që dalin për t'u shlyer të tretëve merren përsipër nga ortaku i vetëm i cili pasi shlyen të gjitha detyrime kapitali i mbetur është i tij.

Neni 20

Shndërimi i shoqerisë në një shoqeri tjetër bëhet me miratim të ortakut,pasi janë plotësuar kërkesat përkatëse.

Neni 21

Të gjitha mosmarveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakut dhe të punësuarëve apo me të tretët kur ato nuk mund të zgjidhen me mirkuptim ,çështja mbetet në kopetenc të gjykatës që e shqyrëton atë.

Neni 22

Çështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë statut,si ato të mardhënies së punës me të punësuarët,detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore,asistencës sociale,të sistemit fiskal,të cilësisë dhe të standarteve etj,do të mbështeten në dispozita ligjore përkatëse në fuqi të nxjerra nga shteti shqipëtar.

Për problemet e çmimeve do të mbahet parasysh kërkesa dhe oferta me perjashtim të rasteve kur me ligj ka kufizime të veçanta.

Neni 23

Ky statut u hartua në Tiranë më 21 shkurt 1994 ,në katër kopjo me fuqi të plotë sejcila.

ORTAKU I VETËM
THEMELUES DHE ADMINISTRATOR
/ GËZIM TOMANI /

2061

# K Ë R K E S Ë

KËRKUESI: Gëzim Tomani ,i biri Nazifit dhe i Dritës,lindur në Tiranë më 20.4.1964 dhe banues po në Tiranë rruga Bajram Curri pall. 490/9 shk.2 ap.8,i martuar me dy fëmijë i punësuar privat.

OBJEKTI : Kërkohet rregjistrimi si person juridik shqipëtar në gjykatën e Tiranës për të ushtruar aktivitetin privat në fushat e më poshme:

Tregëtimin me shumicë dhe pakicë,import eksport të artikujve të ndryshëm si ushqim social ,konfeksione,paisje dhe enë guzhine,ushqimore,prodhime bujqësore e blektorale,bimë mjeksore artikuj industrial,makineri e paisje,pjesë ndërimi,lëndë të para,karburante e lubrifikante,duke bërë dhe ambalazhimin dhe paketimin e tyre.

Përpunimi dhe prodhimi i artikujve të brumit dhe të pastiçeri si dhe aktivitete të tjera që do të shifen me interesë nga shoqeria.

PËRPARA GJYKATËS RRETHIT

T I R A N Ë

I kërkoj gjykatës të rrethit Tiranë ,që pasi të shqyrtoi kërkesën time për t'u rregjistruar në atë gjykatë për të ushtruar veprimtarin private si më sipër të organizuar në shoqeri me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K. të emërtuar " TOMANI" dhe të përfaqësuar nga ortaku i vetëm e administrator përgjegjës Gëzim Tomani.

Veprimtaria e kësaj shoqerie do të ushtrohet në mbështetje të ligjeve të shtetit shqipëtar.

Jemi në pritje të miratimit të kërkesës tonë.

K Ë R K U E S I

ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR

Tiranë 21.2.1994 / GËZIM TOMANI /

Të regjistrohet Dt. 24.II.1994

[signature]